

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8336
E enjte, 9 korrik 2026
Çmimi 0.50 €

Prattipati përsërit thirrjen që Kosova të furnizohet me LNG-në amerikane



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KQZ-ja CERTIFIKON REZULTATET E ZGJEDHJEVE, HAPET RRUGA PËR FORMIMIN E INSTITUCIONEVE

FAQE 4-5



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka certifikuar rezultatet e zgjedhjeve parlamentare të mbajtura më 7 qershor. Në bazë të këtyre rezultateve, Vetëvendosja ka fituar 53 mandate, PDK-ja 22 mandate, LDK-ja 18 man-

date, Aleanca shtatë mandate dhe minoritetet 20 mandate në Kuvend. Me certifikimin e rezultateve është hapur rruga për formimin e institucioneve të reja. Në këtë kontekst, kryetarja e Kuvendit dhe ushtruesja e

detyrës së presidentes së vendit, Albulena Haxhiu, ka për detyrë ta thërrasë seancën konstituive të Kuvendit. Sipas Kushtetutës, seanca konstituive duhet të mbahet brenda 30 ditëve nga certifikimi i rezultateve

AGON BYTYQI RIZGJIDHET ZËVENDËSDREJTOR I AKI-SË EDHE PËR NJË MANDAT PESËVJEÇAR

F. 3



HAMZA TAKOHET ME DREJTORESHËN E NDI-s: KOSOVA DUHET TA PËRSHPEJTOJË RRUGËN DREJT BE-së

F. 3



RENOVA
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



RUTTE: SAMITI I ARDHSHËM I NATO-S DO TË MBAHET NË SHQIPËRI

F. 2

27-VJETORI I VRASJES SË VËLLEZËRVE BYTYQI, KËRROHET PËRGJEGJËSI NGA SERBIA

F. 7


GJINI: KOSOVA KA NEVOJË PËR REFORMIM RADIKAL TË EKONOMISË

F. 5

POLICIA ARRESTON 15 PERSONA DHE MBYLL 19 LOKALE GJATË AKSIONIT KUNDËR TRAFIKIMIT DHE PROSTITUCIONIT

F. 7

EKONOMI



TREGU I INFLUENCERËVE NË KOSOVË: FITIME, REKLAMA DHE PAK KONTROLL

F. 8

SPORT



ZVICRA NË ÇERKFINALE TË KUPËS SË BOTËS, XHAKA DHE MESSI PËRBALLË NJËRI-TJETRIT

F. 11

RUTTE: SAMITI I ARDHSHËM I NATO-S DO TË MBAHET NË SHQIPËRI

ANKARA, 8 KORRIK - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, ka konfirmuar se samiti i ardhshëm i Aleancës do të zhvillohet në Shqipëri. Në deklaratën e tij pas përfundimit të samitit, Rutte ka thënë se vendimi për

organizimin e samitit në Shqipëri është marrë në Samitin e Hagës, ndërsa ka shtuar se ende nuk është përcaktuar data e mbajtjes së tij. "Samiti tjetër do të mbahet në Shqipëri. Ky ishte vendimi i Hagës. Samiti do të

mbahet në Shqipëri, por tani duhet të vendosim për kohën se kur do të zhvillohet", ka thënë Rutte.

Pas kësaj deklarate ka reaguar edhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama. "Si thanë? Nuk do të bëhet samiti

në Shqipëri. Kështu thanë? Epo ka ikur ajo kohë kur bëhej çfarë të donin të tjerët në Shqipëri. Tani Shqipëria bën atë që thotë dhe thotë atë që bën. Kështu që samiti i ardhshëm do të bëhet në Tiranë", ka thënë Rama.



NATO ME DEKLARATË TË PËRBASHKËT PAS SAMITIT TË ANKARASË: 70 MILIARDË EURO PËR UKRAINËN, IRANI NUK DO TË KETË ARMË BËRTHAMORE

ANKARA, 8 KORRIK - Krerët e shteteve dhe të qeverive të vendeve anëtare të NATO-s kanë dalë me një deklaratë të përbashkët pas samitit të zhvilluar në Ankara, ku kanë rikonfirmuar angazhimin e tyre të plotë ndaj parimit të mbrojtjes kolektive të parashikuar në Nenin 5 të Traktatit të Uashingtonit. Në deklaratë është theksuar se "një sulm ndaj një aleati konsiderohet sulm ndaj të gjithë aleatëve".

Në dokument aleatët kanë vlerësuar se Rusia mbetet një kërcënim afatgjatë për sigurinë



euroatlantike, ndërsa terorizmi vazhdon të përbëjë një rrezik të vazhdueshëm. Në këtë kuadër, vendet anëtare

konfirmojnë se po shtojnë investimet në mbrojtje dhe po forcojnë aftësitë e tyre ushtarake.

Deklarata ka nënvizuar se gjatë vitit 2025, aleatët evropianë dhe Kanadaja kanë rritur investimet për nevojat bazë të mbrojtjes me më shumë se 139 miliardë dollarë. Po ashtu, në samitin e Ankarasë janë bërë me dije kontratat e reja të prokurimit me një vlerë që tejkalon 50 miliardë dollarë, si dhe angazhimi për zgjerimin e kapaciteteve të prodhimit ushtarak dhe përsheptimin e inovacionit në industrinë e mbrojtjes.

Sa i përket luftës në Ukrainë, NATO ka rikonfirmuar mbështetjen e saj të

palëkundur për Kievin në mbrojtjen e lirisë, sovranitetit dhe integritetit territorial. Aleatët janë pajtuar që gjatë vitit 2026 të ofrojnë ndihmë ushtarake, pajisje dhe trajnim me vlerë 70 miliardë euro për Ukrainën, duke garantuar se të paktën i njëjti nivel mbështetjeje do të ruhet edhe gjatë vitit 2027. Aleatët e NATO-s kanë ritheksuar se Irani nuk duhet të zotërojë kurrë armë bërthamore dhe i kanë bërë thirrje Iranit të respektojë plotësisht lirinë e lundrimit në ngushticën e Hormuzit.

TRUMPI URDHËRON NDËRPRERJEN E TREGTISË ME SPANJËN

ANKARA, 8 KORRIK - Presidenti amerikan Donald Trump ka deklaruar të mërkurën në Samitin e NATO-s se ka urdhëruar sekretarin e Thesarit të ShBA-së, Scott Bessent, që të ndërpresë të gjithë tregtinë me Spanjën, duke e cilësuar Madridin si një "partner të tmerrshëm" në aleancë.

Trumpi, duke folur së bashku me sekretarin e përgjithshëm

të NATO-s, Mark Rutte, në fillim të samitit në Ankara, tha se nuk dëshiron të bëjë më biznes me Spanjën. Ai ka shprehur vazhdimisht pakënaqësi ndaj Madridit, pasi Spanja nuk është pajtuar me objektivin e ri të NATO-s për shpenzimet e mbrojtjes prej 5 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB). Po ashtu, udhëheqja socialiste spanjolle ka refuzuar t'i lejojë



ShBA-së përdorimin e hapësirës së saj ajrore ose bazave të saj ushtarake për operacionet në Iran.

"Nuk dua të bëj asnjë tregti me

ta, në rregull?", i ka thënë Trumpi, sekretarit të Thesarit, Scott Bessent, i cili është përgjigjur: "Po, zotëri".

"Merreni menjëherë, as mos u flisni atyre. Ata janë të pashpresë. Ata janë njerëz të këqij", ka thënë Trumpi.

Ai ka thënë se Spanja përfiton shumë nga marrëdhëniet tregtare me Shtetet e Bashkuara, por sipas tij kjo situatë do të ndryshojë. "Ata

fitojnë kaq shumë para me ne dhe do të shohim që ata fitojnë shumë më pak. Nuk dua të kem asnjë biznes me ta", deklaroi presidenti amerikan. Shtetet e Bashkuara kanë dy baza të rëndësishme ushtarake në territorin e Spanjës: stacionin Detar Rota dhe Bazën Ajrore Moron, të cilat kanë rol të rëndësishëm në operacionet strategjike të ShBA-së dhe NATO-s.

REZOLUTA E PE-SË: SERBIA PO NGEÇËN PËR SHKAK TË SUNDIMIT TË LIGJIT DHE POLITIKËS SË JASHTME

STRASBURG, 8 KORRIK - Parlamenti Evropian ka miratuar një rezolutë për Serbinë, në të cilën vlerëson se vendi po ngeçen në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian për shkak të përkeqësimit në fushat e sundimit të ligjit, demokracisë, të drejtave themelore dhe përafrimit me politikën e jashtme dhe të sigurisë së BE-së. Në rezolutë është thënë se Serbia nuk ka përmbushur shumicën e detyrimeve të përcaktuara në dokumentin joformal të nëntorit 2024, i cili synonte heqjen e pengesave për hapjen e Kapitullit 3. PE-ja ka kërkuar që Beogradi të dëshmojë me veprime konkrete përkushtim ndaj

vlerave evropiane dhe integritit në BE. Eurodeputetët kanë theksuar se Serbia, për shkak të pozitës së saj gjeopolitike, ka ndikim të rëndësishëm në stabilitetin e Ballkanit Perëndimor, ndërsa kritikojnë përpjekjet për krijimin e sferave të ndikimit dhe veprimet që cenojnë marrëdhëniet me vendet fqinje. Një pjesë e rëndësishme e rezolutës i kushtohet politikës së jashtme të Serbisë. PE-ja i ka bërë thirrje Beogradit që të përafrohet plotësisht me politikën e jashtme dhe të sigurisë së BE-së, përfshirë sanksionet ndaj Rusisë për shkak të agresionit në Ukrainë. Sipas Parlamentit Evropian, përafrimi selektiv nuk është i

mjaftueshëm për një vend kandidat.

Rezoluta shpreh shqetësim për marrëdhëniet e afërta të Serbisë me Rusinë dhe Kinën, investimet e tyre në vend dhe ndikimin e tyre në proceset politike dhe ekonomike. Po ashtu, kritikohet ndikimi i dezinformatave ruse në rajon dhe roli i Serbisë në aktivitetet hibride. PE-ja ka shprehur shqetësim edhe për forcimin ushtarak të Serbisë, bashkëpunimin e saj të sigurisë me Kinën dhe blerjen e pajisjeve ushtarake kineze, duke vlerësuar se këto zhvillime mund të ndikojnë në ekuilibrin rajonal të sigurisë. Në dokument është kërkuar që Serbia të përparojë në fusha si



reforma në drejtësi, lufta kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, zgjedhjet e lira dhe të ndershme, liria e medias, reforma e administratës publike dhe funksionimi i institucioneve demokratike. Parlamenti Evropian gjithashtu ka kritikuar qasjen e Komisionit Evropian ndaj Serbisë, duke kërkuar që çdo regres në fushën e demokracisë dhe sundimit të ligjit të reflektohet në ndihmën

financiare para anëtarësimit. Rezoluta shpreh shqetësim edhe për mbështetjen e ulët të anëtarësimit në BE në mesin e qytetarëve serbë, duke e lidhur këtë me narrativat kundër BE-së dhe dezinformimin e përhapur nga media dhe zyrtarë shtetërorë. Miratimi i rezolutës vjen në kohën kur vendet anëtare të BE-së po diskutojnë mundësinë e vazhdimin të negociatave me Serbinë dhe hapjen e Kapitullit 3. Gjatë debatit në Parlamentin Evropian, shumica e eurodeputetëve kundërshtuan hapjen e këtij kapitulli. Rezolutat e Parlamentit Evropian nuk janë ligjërish detyruese për shtetet anëtare të BE-së apo institucionet evropiane.

Hamza takohet me drejtoreshën e NDI-s: Kosova duhet ta përshejtojë rrugën drejt BE-së

PRISHTINË, 8 KORRIK - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bedri Hamza, ka pritur të mërkurën në takim drejtoreshën e Zyrës së NDI-së në Kosovë, ambasadorën Nancy Soderberg, me të cilën ka diskutuar për zhvillimet politike në vend. Hamza ka vlerësuar rolin e Institutit Demokratik Kombëtar (NDI) në forcimin e demokracisë në Kosovë dhe ka shprehur

mirënjohjen e tij për mbështetjen që kjo organizatë i ka dhënë PDK-së ndër vite. "Jemi falënderues për ndihmën që keni dhënë për ngritjen e kapaciteteve partiake dhe të institucioneve të Kosovës në përgjithësi", ka thënë Hamza. Gjatë takimit është diskutuar edhe për zhvillimet e përgjithshme politike në vend, veçanërisht pas certifikimit të

rezultateve të zgjedhjeve të përgjithshme të 7 qershorit. Hamza ka theksuar se Kosovës i nevojiten institucione qeverisëse që fokusohen në zhvillim ekonomik, forcimin e demokracisë dhe përshejtimin e procesit të integritimit evropian. Ai gjithashtu e ka njoftuar delegacionin e NDI-s për përgatitjet që po zhvillohen për zgjedhjet e brendshme në PDK.



PRATTIPATI PËRSËRIT THIRRJEN QË KOSOVA TË FURNIZOHET ME LNG-në AMERIKANE



PRISHTINË, 8 KORRIK - E ngarkuara me punë në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Anu Prattipati, ka avokuar sërish që Kosova ta diversifikojë furnizimin me energji përmes gazit natyror të lëngshëm amerikan, me qëllim sigurimin e investimeve të ardhshme amerikane. Prattipati këtë thirrje e ka bërë gjatë ceremonisë së ndarjes së Çmimit të

Partneritetit ShBA - Kosovë. Gjithashtu, ajo e ka mirëpritur vendimin e Kosovës për heqjen e tarifave doganore për mallrat amerikane. "E ngarkuara me punë e ShBA-së, Anu Prattipati, mori pjesë në ceremoninë e ndarjes së Çmimit të Partneritetit ShBA-Kosovë, ku u vlerësuan anëtarët e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë për kontributin e tyre në forcimin e tregtisë mes Shteteve të

Bashkuara dhe Kosovës. Në fjalën e saj, ajo mirëpriti vendimin e Kosovës për të hequr tarifën doganore për mallrat amerikane dhe bëri thirrje që Kosova ta diversifikojë furnizimin e saj me energji përmes gazit natyror të lëngshëm (LNG) nga ShBA-ja, me qëllim sigurimin e investimeve të ardhshme amerikane", ka njoftuar Ambasada e ShBA-së. Kujtojmë se javë më parë Prattipati, përmes një

editoriali, i ka bërë thirrje Kosovës t'u bashkohet projekteve amerikane të gazit natyror të planifikuara nëpër Ballkan për të siguruar të ardhmen e saj energjetike. Ajo ka vlerësuar se Kosova duhet të veprojë shpejt për të shfrytëzuar këtë mundësi, duke theksuar se afati për marrjen e një vendimi po përfundon. Sipas Prattipatit, Kosova mund të lidhet përmes projekteve rajonale, si Korridori Vertikal i Gazit dhe

terminali lundruar i gazit natyror në Kroaci, apo përmes gazsjellësit që po ndërtohet për ta lidhur terminalin e Gazit Natyror të Lëngshëm në Aleksandrupolis të Greqisë me Shkupin në Maqedoninë e Veriut. Ajo ka paralajmëruar se vonesat për marrjen e një vendimi të tillë mund ta lënë Kosovën si të vetmen në Ballkanin Perëndimor pa qasje në gazin natyror të lëngshëm amerikan.

Agon Bytyqi rizgjidhet zëvendës drejtor i AKI-së edhe për një mandat pesëvjeçar

PRISHTINË, 8 KORRIK - Ushtruesja e detyrës së presidentes së Kosovës, Albulena Haxhiu dhe kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, kanë nënshkruar vendimin që Agon Bytyqi të vazhdojë edhe për pesë vitet e ardhshme detyrën e zëvendës drejtorit të Agjencisë së Kosovës për

Inteligjencë. Haxhiu ka thënë se provoja e tij, njohja e institucionit dhe përgjegjësia e dëshmuar gjatë mandatit të parë janë të rëndësishme për vazhdimësinë dhe punën profesionale të AKI-së në mbrojtje të sigurisë së vendit. Në fund, kererët e shtetit kanë falënderuar Bytyqin për

punën e deritanishme dhe i kanë uruar mbarësi në mandatin e ri. "Përvoja e tij, njohja e institucionit dhe përgjegjësia e dëshmuar gjatë mandatit të parë janë të rëndësishme për vazhdimësinë dhe punën profesionale të AKI-së në mbrojtje të sigurisë së vendit", ka thënë Haxhiu.





KQZ-ja CERTIFIKON REZULTATET E ZGJEDHJEVE, HAPET RRUGA PËR FORMIMIN E INSTITUCIONEVE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka certifikuar rezultatet e zgjedhjeve parlamentare të mbajtura më 7 qershor. Në bazë të këtyre rezultateve, Vetëvendosja ka fituar 53 mandate, PDK-ja 22 mandate, LDK-ja 18 mandate, Aleanca shtatë mandate dhe minoritetet 20 mandate në Kuvend. Me certifikimin e rezultateve është hapur rruga për formimin e institucioneve të reja. Në këtë kontekst, kryetarja e Kuvendit dhe ushtruesja e detyrës së presidentes së vendit, Albulena Haxhiu, ka për detyrë ta thërrasë seancën konstituive të Kuvendit. Sipas Kushtetutës, seanca konstituive duhet të mbahet brenda 30 ditëve nga certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve

afatesh parasheh ligji? A mund të zhbllkohet procesi nëse partitë nuk arrijnë marrëveshje?

Çfarë pas certifikimit?

Pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, kryeparlamentarja, njëherësh ushtruese e detyrës së presidentes së vendit, Albulena Haxhiu, e ka për detyrë ta thërrasë seancën konstituive të Kuvendit. Sipas Kushtetutës, seanca duhet të mbahet brenda 30 ditëve nga certifikimi i rezultateve. Në këtë seancë bëhet konstituimi i Kuvendit, zgjidhen kryetari dhe nënkryetarët, ndërsa më pas vazhdohet me procedurat për formimin e qeverisë së re. Pas konstituimit të Kuvendit, Haxhiu e mandaton partinë fituese të zgjedhjeve për formimin e qeverisë, në këtë rast Lëvizjen Vetëvendosje.

Cakolli: Pas certifikimit të zgjedhjeve nis afati për konstituimin e Kuvendit, më pas procedurat për qeverinë ose presidentin

Eugen Cakolli nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka

bërë me dije se pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, fillon rrjedhja e afateve kushtetuese për krijimin e institucioneve të reja të vendit. Ai ka sqaruar procedurat për thirrjen dhe mbajtjen e seancës konstituive të Kuvendit si dhe mënyrën e drejtimit të saj. “Me certifikimin e rezultateve nga KQZ-ja, prej nesër fillojnë të rrjedhin afatet kushtetuese për krijimin e institucioneve të reja. Afati 30-ditor për mbajtjen dhe përmbylljen me sukses të seancës konstituive të Kuvendit fillon nesër, më 9 korrik, dhe përfundon më 7 gusht 2026. Seanca duhet të thirret nga Albulena Haxhiu, në cilësinë e ushtrueses së detyrës së Presidentes. Nëse kjo nuk ndodh brenda afatit, Kuvendi mblidhet vetë në ditën e tridhjetë. Para seancës, Albulena Haxhiu, në cilësinë e kryetares së legjislaturës së kaluar, duhet ta thërrasë mbledhjen përgatitore me kryetarët e 15 subjekteve politike që kanë fituar ulëse në Kuvend. Kjo mbledhje mbahet jo më vonë se pesë ditë para seancës konstituive dhe shërben për përgatitjen e rendit të ditës dhe caktimin e vendeve ku do të ulen deputetët në sallë, sipas

subjekteve politike. Seancën konstituive, deri në zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit, do ta drejtojë deputeti më i vjetër, Avni Dehari nga LV-ja, i ndihmuar nga deputetja më e re, Fatma Taçi nga KDTP-ja”, ka thënë Cakolli.

Sipas Cakollit, vetëm pas konstituimit të plotë të Kuvendit mund të nisnin procedurat kushtetuese për zgjedhjen e qeverisë së re ose të presidentit, duke theksuar se as Kushtetuta dhe as aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese nuk përcaktojnë se cila prej tyre duhet të ndodhë më parë. “Rendi i punës është i paracaktuar. Fillimisht formohet Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe Mandateve, raporti i të cilit votohet me shumicë votash. Më pas bëhet betimi i deputetëve, votohet kryetari i Kuvendit dhe, në fund, zgjidhen nënkryetarët. Kryetari i Kuvendit propozohet nga LV-ja, si subjekti më i madh parlamentar, dhe zgjidhet me së paku 61 vota. Nëse i njëjti kandidat nuk i merr votat pas tri tentimeve, duhet të propozohet një kandidat tjetër. Votimi për kryetarin duhet të jetë i hapur, përveç nëse ka konsensus për ndryshimin e mënyrës së

**EPOKA
ERE**

Lirim GECI

PRISHTINË, 8 KORRIK - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka certifikuar rezultatet e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare rreth një muaj pas mbajtjes së tyre. Votimet e 7 qershorit ishin zgjedhjet e treta parlamentare që Kosova ka organizuar në më pak se një vit e gjysmë. Lëvizja Vetëvendosje (LV) ka fituar 53 mandate, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka fituar 22 ulëse, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) 18 ulëse, ndërsa

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) shtatë ulëse. Në mbledhjen e KQZ-së, të mbajtur të mërkurën, kryetari i këtij institucioni, Kreshnik Radoniqi, ka njoftuar se vetëm në listën e deputetëve të Aleancës ka ndryshime, pasi dy deputetë të zgjedhur kanë hequr dorë nga mandati. Për rrjedhojë, Adrian Gjini dhe Daut Haradinaj do të zëvendësohen nga Bekë Berisha dhe Burim Ramadani. Çfarë nënkupton certifikimi i rezultateve? Cilët janë hapat e radhës drejt formimit të institucioneve të reja dhe çfarë

GJINI: KOSOVA KA NEVOJË PËR REFORMIM RADIKAL TË EKONOMISË

PRISHTINË, 8 KORRIK - Kryetari i Aleancës, Ardian Gjini, ka reaguar pas parashikimeve të Fondit

Monetar Ndërkombëtar (FMN) për rritjen ekonomike të Kosovës, duke vlerësuar se këto shifra nuk duhet të interpretohen me triumfalizëm politik pasi, sipas tij, nuk pasqyrojnë realitetin ekonomik të qytetarëve.

Në "Facebook", Gjini ka theksuar se Kosova vazhdon të ketë Bruto Produktin Vendor (GDP) më të ulët për kokë banori në rajon, ndërsa hendeku me vendet fqinje dhe Bashkimin Evropian mbetet i madh. Sipas tij, një rritje ekonomike prej rreth 4-përqindësh nuk është e mjaftueshme për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm, pasi ajo mbështetet kryesisht në

konsumin e brendshëm dhe remitancat, e jo në prodhim, industri dhe eksporte.

Gjini ka paraqitur edhe një analizë krahasuese, sipas së cilës, nëse vazhdon ritmi aktual i rritjes ekonomike, Kosovës do t'i duhen rreth tetë vjet për të arritur nivelin e Bosnjë-Hercegovinës, 13 vjet atë të Maqedonisë së Veriut, 20 vjet Shqipërinë, 54 vjet Malin e Zi, 77 vjet Serbinë dhe më shumë se 130 vjet për ta arritur mesataren e Bashkimit Evropian. Ai ka theksuar se inflacioni në vitet e fundit ka dobësuar fuqinë blerëse të qytetarëve, duke bërë që rritja ekonomike të mos reflektohet në përmirësimin e standardit të jetesës.

Në fund të reagimit të tij, kryetari i Aleancës ka bërë

thirrje për ndryshim të menjëhershëm të politikave ekonomike, duke kërkuar mbështetje për prodhuesit vendorë, investime në teknologji, krijimin e vendeve të punës me vlerë të shtuar dhe rritjen e eksporteve. Sipas tij, Kosova duhet të kalojë nga një ekonomi e mbështetur në konsum, në një ekonomi të bazuar në prodhim dhe zhvillim afatgjatë.

Ndërkohë, ministri në detyrë i Financave, Hekuran Murati, ka vlerësuar raportin e publikuar nga "Euronews", i cili u referohet parashikimeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), sipas të cilave, Kosova pritet të jetë ndër vendet me rritjen ekonomike më të shpejtë në Evropë në vitet e ardhshme.



votimit. Pas zgjedhjes së kryetarit, Kuvendi vazhdon me zgjedhjen e pesë nënkryetarëve.

Tre propozohen nga tri subjektet më të mëdha parlamentare: LV-ja, PDK-ja dhe LDK-ja. Një propozohet nga deputetët e komunitetit serb, përkatësisht nga Lista Serbe, ndërsa një nga deputetët e komuniteteve të tjera joshumicë. Të gjithë zgjidhen me së paku 61 vota. Parimisht, nënkryetarët duhet të votohen në pako. Së paku tre nënkryetarët e propozuar nga subjektet më të mëdha parlamentare mund të votohen në një votim, ndërsa dy nënkryetarët nga

komunitetet joshumicë në një votim tjetër", ka thënë Cakolli, duke shtuar se Kuvendi konsiderohet i konstituuar vetëm pasi të jenë zgjedhur kryetari dhe të pesë nënkryetarët. "Vetëm pas konstituimit të plotë të Kuvendit hapen dy procedura të ndara kushtetuese: ajo për formimin e qeverisë dhe ajo për zgjedhjen e presidentit. Këto procedura nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën dhe as Kushtetuta, as aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese nuk e kushtëzojnë formimin e qeverisë me zgjedhjen paraprake të presidentit", ka thënë Cakolli.

Haxhiu: Seanca konstituive e Kuvendit do të thirret brenda afatit kushtetues

Ushtruesja e detyrës së presidentes së Kosovës, Albulena Haxhiu, ka reaguar pas certifikimit të rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve parlamentare të 7 qershorit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ). Haxhiu ka bërë me dije se, në përputhje me përgjegjësitë e saj kushtetuese, seanca konstituive e Kuvendit të Republikës së Kosovës do të thirret brenda afatit të përcaktuar me Kushtetutë. Ajo e ka cilësuar certifikimin e rezultateve si përmbyllje të një procesi të rëndësishëm demokratik për vendin. "Sot, me certifikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të 7 qershorit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përmbyllet një proces i rëndësishëm demokratik për Republikën tonë. Vullneti i

qytetarëve, i shprehur me votë brenda vendit dhe nga bashkatdhetarët tanë, ka marrë tashmë formën e tij përfundimtare institucionale", ka shkruar Haxhiu në "Facebook". Ajo ka falënderuar institucionet zgjedhore dhe të gjithë ata që kanë kontribuar në organizimin dhe përmbylljen e procesit zgjedhor. "Besimi i dhënë nga qytetarët është një përgjegjësi e madhe. Çdo mandat duhet të ushtrohet me integritet, llogaridhënie dhe përkushtim të palëkundur në shërbim të interesit publik, demokracisë dhe të ardhmes së Republikës sonë", ka deklaruar Haxhiu. Sipas saj, thirrja e seancës konstituive do t'i hapë rrugë themelimit të institucioneve të reja, të dala nga vullneti i qytetarëve.

Përbërja e Kuvendit të Kosovës sipas rezultateve të certifikuara

LV-ja 53 mandate

Albin Kurti
Glauk Konjufca
Albulena Haxhiu
Hekuran Murati
Donika Gërvalla-Schwarz
Xhelal Sveçla
Avni Dehari
Ejup Maqedonci
Hajrulla Çeku
Mimoza Kusari-Lila
Shqipe Mehmeti Selimi
Andin Hoti
Ilir Kërçeli
Arben Viti
Saranda Bogujevci
Osman Musliu
Nezir Kraki
Alban Bajrami
Arton Konushevi
Edona Llaloshi
Mefail Bajqinovci
Ardian Gola
Armend Baloku
Armend Muja
Arbëreshë Kryeziu-Hyseni
Arbër Rexhaj
Rufki Suma
Blerim Gashi
Fitore Pacolli-Dalipi
Artane Rizvanolli-Berisha
Adriana Matoshi
Agim Bahtiri
Arjeta Fejza
Taulant Kelmendi
Arbërie Nagavci
Krenare Çerkini
Dimal Basha
Liza Gashi
Labinotë Demi-Murtezi
Artan Abrashi
Adnan Rrustemi
Adelina Grainca
Valon Ramadani
Salih Zyba
Enver Haliti
Fatmire Kollçaku
Valon Hoti
Valon Peci
Drita Pajaziti
Sylejman Mehollu
Jeton Raka
Vigan Qorrolli
Fjolla Ujkani

PDK-ja 22 mandate

Bedri Hamza
Përparim Gruda
Arian Tahiri
Uran Ismaili
Vlora Çitaku
Sala Jashari
Ganimete Musliu
Enver Hoxhaj
Arben Mustafa
Rahman Rama
Mërgim Lushtaku
Elmi Reçica
Besa Kabashi-Ramaj
Jakup Nura
Eman Rrahmani
Altin Krasniqi
Artan Behrami
Fadil Demaku
Blerta Deliu-Kodra
Rrustem Mustafa
Eliza Hoxha
Ariana Musliu-Shoshi

LDK-ja 18 mandate

Vjosa Osmani
Lumir Abdixhiku
Doarsa Kica-Xhelili
Hykmete Bajrami
Avdullah Hoti
Ukë Rugova
Kujtim Shala
Anton Quni
Lutfi Haziri
Armend Zemaj
Besiana Mustafa
Janina Ymeri
Ermal Sadiku
Jehona Lushaku-Sadriu
Arben Gashi
Albena Reshitaj
Fadil Hadergjonaj
Paris Guri

Aleanca 7 mandate

Ramush Haradinaj
Besnik Tahiri
Time Kadrijaj
Albana Bytyqi
Teuta Haxhiu
Bekë Berisha
Burim Ramadani

Lista Serbe 9 mandate

Zlatan Elek
Igor Simiq
Sërgjan Popoviq
Slavko Simiq
Jovana Radosavljeviq
Liljana Stefanoviq
Milan Joksimoviq
Branislav Nikoliq
Tanja Vujoviq

Koalicioni Demokratik i Turqve

të Kosovës (KDTP)
Fikrim Damka
Fatma Taçi

Za Slobodu, Pravdu i Opstanak (ZSPO)
Nenad Rashiq

Koalicija Vakati
Rasim Demiri

Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK)
Elbert Krasniqi

Nova Demokratska Stranka (NDS)
Emilija Rexhepi

Socijaldemokratska Unija (SDU)
Duda Balje

Partia Ashkalinjve për Integrim (PSA)
Artan Asllani

Partia Liberale Egjiptiane (PLE)
Veton Berisha

Jedinstvena Goranska Partija (JGP)
Adem Hoxha

Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK)
Albert Kinolli

Haxhiu pret në takim lamtumirës ambasadorin e Zvicrës në Kosovë

PRISHTINË, 8 KORRIK - Ushtruesja e detyrës së presidentes së Kosovës, Albulena Haxhiu, ka pritur në takim lamtumirës ambasadorin e Zvicrës në Kosovë, Jurg Sprecher. Në

"Facebook", Haxhiu ka bërë me dije se e ka falënderuar ambasadorin Sprecher për bashkëpunimin gjatë mandatit të tij dhe për angazhimin në forcimin e marrëdhënieve

ndërmjet Kosovës dhe Zvicrës. "Kosova dhe Zvicra kanë lidhje të thella, të ndërtuara edhe nga breza të bashkatdhetarëve tanë që Zvicrën e kanë bërë shtëpinë e tyre të dytë.

Ambasadorit Sprecher i urova suksese në angazhimet e ardhshme, me mirënjohje për kontributin dhe miqësinë e tij ndaj Kosovës", ka shkruar Haxhiu.



27-VJETORI I VRAËSIES SË VËLLEZËRVE BYTYQI, KËRKOHET PËRGJEGJËSI NGA SERBIA

PRISHTINË, 8 KORRIK - Organizata Albanians For America ka përkujtuar Agron, Mehmet dhe Ylli Bytyqin në 27-vjetorin e vrasjes së tyre, duke bërë thirrje që autorët dhe urdhërdhënësit e ekzekutimit të tre vëllezërve shqiptaro-amerikanë të dalin para drejtësisë. Kjo organizatë ka rikujtuar se tre vëllezërit Bytyqi, pjesëtarë të Batalionit 'Atlantiku', kanë luftuar nën emblemën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për lirinë e vendit, por më pas janë arrestuar, dënuar me burgim nga autoritetet serbe dhe janë ekzekutuar nga strukturat shtetërore të Serbisë. "Sot përkujtojmë me respekt Agron, Mehmet dhe Ylli Bytyqi, tre vëllezër shqiptaro-amerikanë, pjesëtarë të Batalionit 'Atlantiku', të cilët, nën emblemën e UÇK-së, luftuan për lirinë e Kosovës, por u ekzekutuan mizorisht nga strukturat shtetërore serbe, pasi që paraprakisht ishin arrestuar dhe dënuar me burg nga autoritetet e Serbisë",

është thënë në reagimin Albanians For America.

Albanians For America ka vlerësuar se edhe pas gati tri dekadash, drejtësia për rastin Bytyqi mbetet e porealizuar. "Ky përvjetor na kujton se drejtësia e vonuar dhe e mohuar mbetet padrejtësi. Edhe pas 27 vitesh, urdhërdhënësit dhe ekzekutorët e këtij krimi nuk janë nxjerrë para drejtësisë", ka theksuar Albanians For America. Sipas saj, pavarësisht prej kërkesave të vazhdueshme të Shteteve të Bashkuara dhe premtimeve të përsëritura nga zyrtarët serbë, familja Bytyqi ende pret që autorët e krimit të mbajnë përgjegjësi.

"Pavarësisht prej premtimeve të përsëritura të zyrtarëve serbë dhe kërkesave të pandërprera të Shteteve të Bashkuara, familja Bytyqi vazhdon të presë drejtësi, ndërsa Serbia vazhdon të mos japë përgjigjen që i detyrohet të vërtetës dhe ligjit", është thënë në reagimin e Albanians For America.



Në fund organizata ka ritheksuar se zbardhja e plotë e këtij rasti është një detyrim jo vetëm ndaj familjes Bytyqi, por edhe një test për përgjegjësinë

institucionale të Serbisë. "Vendosja e drejtësisë nuk është vetëm një detyrim ndaj familjes së tyre, por edhe një provë e gatishmërisë së Serbisë

për të marrë përgjegjësi për një krim të kryer nga strukturat e saj shtetërore", është thënë në reagimin e Albanians For America.

GËRVALLA: LIGJI PËR PRONËN PUBLIKE SYNON TA FORCOJË SIGURINË JURIDIKE



PRISHTINË, 8 KORRIK - Ministria në detyrë e Drejtësisë, Donika Gërvalla, ka deklaruar se ndryshimet në Ligjin për Pronën Publike synojnë krijimin e një kornize të qartë ligjore e cila garanton siguri juridike dhe administrim më efikas të pronës publike.

Gjatë hapjes së punëtorisë për shqyrtimin dhe finalizimin e Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Pronën Publike, Gërvalla ka thënë se ndryshimi i këtij ligji është i domosdoshëm për t'i adresuar sfidat e evidentuara gjatë zbatimit të tij. Ajo ka theksuar se

suksesi i kësaj reforme varet edhe nga harmonizimi i Ligjit për Pronën Publike me legjislacionin tjetër që rregullon këtë fushë. Sipas Gërvallës, prona publike është pasuri e Republikës së Kosovës dhe administrimi i saj kërkon rregulla të qarta, përgjegjësi institucionale dhe një vizion afatgjatë. Ajo ka bërë me dije se ndryshimet e propozuara kanë për qëllim mbrojtjen e interesit publik, duke krijuar njëkohësisht kushte më të favorshme për zhvillimin ekonomik dhe tërheqjen e investimeve. Gërvalla ka vlerësuar se një

kuadër ligjor i qartë, i harmonizuar dhe i parashikueshëm është parakusht për forcimin e sundimit të ligjit, rritjen e besimit në institucione dhe krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm për të gjithë aktorët që ndërveprojnë me pronën publike. Ajo ka shtuar se synimi i Ministrisë së Drejtësisë është që, përmes një procesi gjithëpërfshirës dhe konsultimeve me institucionet dhe aktorët relevantë, të finalizohet sa më shpejt drafti i projektligjit i cili më pas do të procedohet për miratim në qeveri.

Batllavës dhe Badocit u nevojitet ende ujë

PRISHTINË, 8 KORRIK - Gjendja aktuale e rezervuarëve të ujit në Kosovë tregon se liqeneve të Batllavës dhe Badocit u nevojitet ende rritje e nivelit të ujit për ta arritur

kapacitetin maksimal të mbushjes. Sipas të dhënave të Kompanisë Rajonale të Ujësjetës "Prishtina", Liqenit të Batllavës i mungojnë edhe 1.23 metra

ujë për ta arritur nivelin maksimal, ndërsa Liqenit të Badocit i mungojnë edhe 1.90 metra. KRU "Prishtina" ka bërë thirrje për kujdes të

përdorimit të ujit dhe mbrojtjen e burimeve ujore, duke theksuar rëndësinë e menaxhimit të qëndrueshëm të rezervave të ujit.



Dëmtohet objekti përcjellës në Kompleksin Memorial "Zahir Pajaziti", policia nis hetimet

PODUJEVË, 8 KORRIK - Policia e Kosovës ka nisur hetimet për një rast të dëmtimit të pronës në Kompleksin Memorial "Zahir Pajaziti" në Orllan të Podujevës.

Në raportin 24-orësh të policisë, rasti është raportuar për periudhën nga 30 maji deri më 30 qershor 2026. Pas pranimit të informatës, njësitë policore kanë dalë në vendin e

ngjarjes, ku në objektin përcjellës, përkatësisht në kullë, kanë konstatuar disa dëmtime në tavan dhe në korridorin e objektit. "Njësitë policore, pas pranimit të informatës lidhur me rastin, kanë dalë në vendin e ngjarjes dhe në objektin përcjellës - në kullë kanë vërejtur disa dëmtime në tavan dhe në korridorin e objektit. Lidhur

me rastin është informuar edhe prokurori, ndërsa njësitë policore janë duke hetuar rastin", është thënë në raportin e policisë.

Për rastin është njoftuar prokurori kompetent, ndërsa njësitë policore po zhvillojnë hetime për t'i sqaruar rrethanat e dëmtimit dhe për t'i identifikuar personat përgjegjës.



POLICIA ARRESTON 15 PERSONA DHE MBYLL 19 LOKALE GJATË AKSIONIT KUNDËR TRAFIKIMIT DHE PROSTITUCIONIT

PRISHTINË, 8 KORRIK - Policia e Kosovës ka arrestuar 15 persona dhe ka mbyllur 19 lokale gjatë zbatimit të Planit operativ "Ditët e veprimit të përbashkët - JAD Global Chain 2026 - Qershor 2026", i realizuar në bashkëpunim me EUROPOL-in, INTERPOL-in, FRONTEX-in dhe institucione të tjera vendore. Sipas njoftimit të policisë, operacioni është zhvilluar nga 8 deri më 12 qershor 2026 dhe ka përfshirë kontrolle në qendra masazhi, lokale të muzikës "live", si dhe zbatimin e një plani taktik lidhur me eskortat. Gjatë aksionit janë inspektuar 59 lokale të muzikës "live" dhe 62 qendra masazhi në të gjithë territorin e Kosovës. Në lokalet e muzikës "live" janë



identifikuar gjithsej 420 persona, prej të cilëve 317 gra dhe 103 burra. Nga ky numër, 186 persona ishin shtetas të Kosovës, ndërsa 234 shtetas të huaj, kryesisht nga Shqipëria, Serbia, Maqedonia e Veriut dhe

Bullgaria. Ndërkohë, në 62 qendrat e masazhit janë hasur 104 persona, prej të cilëve 89 gra dhe 15 burra. Sipas Policisë, 60 prej tyre ishin shtetas të Kosovës, ndërsa 44 shtetas të huaj nga Shqipëria, Tajlanda, Filipinet dhe Malavia. Për shkak të shkeljeve administrative, inspektorët kanë mbyllur nëntë lokale të muzikës live dhe dhjetë qendra masazhi, ndërsa gjashtë lokale të muzikës live janë gjetur të mbyllura në momentin e inspektimit.

Policia e Kosovës ka bërë me dije se gjatë këtij operacioni nuk është identifikuar asnjë rast i veprës penale "Trafikim i njerëzve". "Gjatë realizimit të këtij plani nuk është

identifikuar ndonjë rast i veprës penale "Trafikim i njerëzve", ka njoftuar policia. Në kuadër të operacionit janë evidentuar shtatë raste të dyshuara për veprën penale "Keqtrajtim apo braktisje e fëmijës". Për këto raste janë arrestuar shtatë gra, katër prej tyre shtetase të Shqipërisë, një shtetase e Malit të Zi dhe dy shtetase të Kosovës, të cilat dyshohet se kërkonin lëmshë në rrugë së bashku me fëmijët e tyre.

Trembëdhjetë fëmijë janë trajtuar në bashkëpunim me qendrat për punë sociale. Po ashtu, policia ka evidentuar katër raste të kundërvajtjes "Marrje me prostitucion" në kuadër të planit për eskortat. Në këto raste janë arrestuar


tetë persona, katër shtetas të Kosovës dhe katër shtetase të huaja, përkatësisht dy nga Brazili dhe dy nga Kolumbia. Sipas policisë, të gjitha gratë e hasura duke punuar në lokalet e muzikës "live", qendrat e masazhit dhe në aktivitetet e eskortës janë intervistuar dhe u është ofruar mundësia që të deklarojnë nëse kanë qenë viktimë të ndonjë forme të shfrytëzimit. "Të gjitha punëtorëve të hasura duke punuar në lokalet e muzikës, qendrat e masazhit dhe në eskorta u është dhënë mundësia e deklarimit nëse ndonjëra prej tyre është viktimë e ndonjë forme të shfrytëzimit (trafikimit), mirëpo nuk ka rezultuar me asnjë rast", ka njoftuar policia.

NË KLINIKËN E NEUROKIRURGJISË NË QKUK REALIZOHEN DY OPERACIONE TË RRALLA ME TEKNIKËN E NEUROENDOSKOPISË

PRISHTINË, 8 KORRIK - Klinika e Neurokirurgjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës ka realizuar për herë të parë me sukses ndërhyrje neurokirurgjikale me teknikën e neuroendoskopisë, një metodë moderne dhe minimalisht invazive që përdoret në kirurgjinë e trurit. Sipas njoftimit të QKUK-së, ndërhyrjet janë realizuar më 6 dhe 7 korrik, në bashkëpunim me neurokirurgun nga Gjermania, dr. Gousias Konstantinos, i cili së bashku

me ekipin e Klinikës së Neurokirurgjisë ka udhëhequr realizimin e këtyre procedurave të avancuara. Gjatë kësaj vizite janë kryer me sukses dy ndërhyrje të avancuara kirurgjikale: heqja e një tumori të hipofizës përmes qasjes neuroendoskopike dhe heqja e një tumori të ventrikulit të tretë të trurit, po ashtu përmes teknikës së neuroendoskopisë.

Në të dy operacionet është përdorur edhe neuronavigatori, një pajisje



moderne që mundëson orientim të saktë anatomik gjatë ndërhyrjes. Sipas QKUK-së, përdorimi i kësaj

teknologjie rrit sigurinë e procedurës dhe mundëson realizimin e operacioneve me precizitet të lartë në përputhje me standardet bashkëkohore të neurokirurgjisë.

Sipas Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës (ShSKUK), të dy pacientët janë në gjendje të mirë shëndetësore dhe po vazhdojnë trajtimin dhe rikuperimin sipas planit të përcaktuar nga ekipi mjekësor. Përveç rëndësisë klinike, vizita e specialistit nga

Gjermania ka pasur edhe rëndësi profesionale dhe edukative për stafin e Klinikës së Neurokirurgjisë. Gjatë realizimit të procedurave, neurokirurgët, anesteziologët, infirmierët instrumentarë dhe personeli i sallës operative kanë marrë pjesë në trajnim praktik, duke përfutur njohuri dhe përvojë të drejtpërdrejtë në zbatimin e teknikave moderne të neuroendoskopisë dhe përdorimin e neuronavigtorit.

Kurti: Kosova po hyn në një fazë të re të tranzicionit energjetik

PRISHTINË, 8 KORRIK - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, është kthyer në Kosovë pas pjesëmarrjes në simpoziumin Symi në Greqi dhe ka marrë pjesë në shënimin e 20-vjetorit të themelimit të Operatorit të Sistemit, Transmetimit dhe Tregut (KOSTT). Në fjalën e tij, Kurti ka vlerësuar punën dydekadëshe të KOSTT-it, duke thënë se Kosova po hyn në një fazë të re të tranzicionit

energjetik, në një kohë kur Shtetet e Bashkuara po bëjnë thirrje që vendi ta diversifikojë furnizimin me energji përmes gazit natyror të lëngshëm (LNG) amerikan. "Në të njëjtën kohë, Kosova po hyn tash në një fazë të re të tranzicionit energjetik. Integrimi i burimeve të ripërtërishme të energjisë, ndërtimi i kapaciteteve të reja solare dhe të erës, instalimi i sistemeve të baterive për

akumulimin e energjisë, si dhe modernizimi e rindërtimi i kapaciteteve ekzistuese gjeneruese që sigurojnë furnizimin bazë, do ta transformojnë mënyrën se si prodhojmë, transmetojmë dhe konsumojmë energji", ka thënë Kurti, duke shtuar se KOSTT-i nuk përfaqëson vetëm infrastrukturën energjetike, por edhe njerëzit që e kanë ndërtuar dhe zhvilluar institucionin ndër vite.



TREGU I INFLUENCERËVE NË KOSOVË: FITIME, REKLAMA DHE PAK KONTROLL

PRISHTINË, 8 KORRIK - A keni menduar ndonjëherë nëse produktet që i lavdërojnë influencerët janë vërtet të mira, apo nëse bëhet fjalë për reklamë të paguar? Në Kosovë kjo nuk është gjithmonë e qartë për ndjekësit. Në "Instagram", "TikTok" dhe platforma të tjera online, influencerët reklamojnë çdo ditë produkte kozmetike, veshje, restorante, vetura, pompa derivate dhe shërbime të ndryshme, por institucionet nuk kanë një pasqyrë të plotë për këtë treg: sa para qarkullojnë, kush paguan tatime, dhe kush kujdeset që reklamat e paguara të dallohen nga rekomandimet personale. Me termin influencerë zakonisht përshkruhen krijuesit e përmbajtjes në rrjetet sociale të cilët kanë ndjekës të shumtë dhe përdorin ndikimin e tyre për të promovuar produkte, shërbime, marka apo ide.

Të ardhura të tatueshme

Sipas Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), veprimtaria e influencerëve që fitojnë të ardhura përmes krijimit dhe shpërndarjes së përmbajtjes në rrjetet sociale konsiderohet aktivitet ekonomik dhe, si e tillë, të ardhurat nga kjo veprimtari janë të tatueshme sipas legjislacionit në fuqi. Por, institucioni që mbledh tatimet nuk ka një pasqyrë të veçantë për këtë kategori.

Fatime Krasniqi, zyrtare e lartë për komunikim me publikun në ATK, në një përgjigje me shkrim për "Radion Evropa e Lirë", ka thënë se nuk mund të ofrojë të dhëna statistikore për numrin e influencerëve që deklarojnë të ardhura apo paguajnë tatime, sepse ata nuk evidentohen si kategori e veçantë në sistemin tatimor. Në sistemin e ATK-së, tatimpaguesit ndahen sipas statusit juridik: individët apo bizneset individuale regjistrohen si persona fizikë, ndërsa format e tjera të regjistrimit trajtohen si persona juridikë. Sipas Krasniqit, nëse një person ka kontratë pune apo kontratë për shërbime të veçanta, që krijon raport punëdhënës-punëmarrës, atëherë ai duhet të evidentohet në listën e pagave të biznesit që e ka kontraktuar. Ajo shton se nëse këta persona ushtrorjnë veprimtari ekonomike në mënyrë të pavarur, atëherë janë të obliguar të regjistrohen si biznese, sipas aktivitetit përkatës.

Fushatë informuese, pa plan të qartë kontrolli

ATK-ja në prill të këtij viti ka nisur edhe një fushatë informuese për influencerët, bloggerët, freelancerët dhe personat e tjerë që krijojnë të



ardhura online. Përmes një videoje në rrjetet sociale, ATK-ja ka njoftuar për një takim me disa influencerë, duke thënë se qëllimi i fushatës ishte informimi i tyre për detyrimet ligjore dhe rritja e transparencës. Por, nga njoftimi publik nuk është bërë e qartë se si do të zhvillohet fushata, sa influencerë synon të përfshijë, nëse do të ketë kontrole konkrete, apo nëse ATK-ja planifikon të krijojë ndonjë mënyrë më të qartë për evidentimin e kësaj kategorie.

Kontrolli i kufizuar, regjistrime të pakta

Nga 12 influencerë që "Radio Evropa e Lirë" ka kontaktuar për këtë temë, asnjëri nuk ka pranuar t'u përgjigjet pyetjeve për mënyrën se si paguhen, nëse kanë kontrata me bizneset dhe nëse deklarojnë të ardhura. Në të dhënat e Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), vetëm tre prej tyre figurojnë si biznese të regjistruara. Nga këta tre, vetëm njëri është i regjistruar me aktivitet kryesor në fushën e publicitetit, ndërsa dy të tjerët janë të regjistruar për fotografim dhe për shpërndarje të filmave, videove e programeve televizive.

Ish-drejtori i ATK-së, Ilir Murtezaj, ka thënë se aspekti ligjor nuk ka ndryshuar asgjë, dhe se "influencerët kanë qenë dhe janë të obliguar të paguajnë tatim për të ardhurat që realizojnë".

Por, se sa mund të fitojë shteti nga ky aktivitet, Murtezaj vlerëson se askush nuk mund ta thotë me saktësi. Edhe profesori i Ekonomisë, Shkumbin Misini, ka thënë se problemi nuk qëndron te mungesa e ligjeve, por te zbatimi i tyre. Ai ka vlerësuar se ATK-ja nuk ka qenë mjaftueshëm aktive në kontrollimin e kësaj veprimtarie. "Për influencerët, është mundësi e artë për t'iu ikur obligimeve tatimore, sepse ATK-ja është shumë pasive në

këtë drejtim", ka thënë ai. Misini ka theksuar se ATK-ja duhet t'i informojë më mirë influencerët për detyrimet tatimore, por edhe të forcojë kontrollin ndaj tyre. Ai ka rekomanduar gjoba dhe masa ndëshkuese për ata që nuk i deklarojnë të ardhurat, si dhe krijimin e një baze të dhënash, që do t'i ndihmonte institucionet të kenë pasqyrë më të qartë për këtë treg.

Reklamat e fshehta dhe mungesa e standardeve

Por, tregu i influencerëve nuk ngre vetëm pyetje tatimore. Valon Canhasi, drejtor i agjencisë së mediave sociale "Hallakate", ka thënë se ky treg në Kosovë ende nuk është mjaftueshëm i rregulluar, dhe se ka nevojë për më shumë standarde profesionale, transparencë dhe përgjegjësi. Sipas tij, një nga problemet kryesorë është se publiku shpesh nuk e di nëse përmbajtja që sheh në rrjetet sociale është rekomandim personal apo reklamë e paguar. "Duhet të jetë e qartë kur një përmbajtje është reklamë apo bashkëpunim i paguar. Kjo është e rëndësishme për konsumatorin, sidomos kur promovohen produkte që lidhen me shëndetin, financat, produktet për fëmijë, apo kategori të tjera të ndjeshme", ka thënë Canhasi.

Ai ka theksuar se në treg mungojnë shpesh edhe kontratat e qarta mes bizneseve dhe influencerëve, rregullimi i të drejtave për përdorimin e përmbajtjes, raportimi profesional i rezultateve të fushatave, dhe praktikat e rregullta të deklarimit të të ardhurave. Për obligimet që kanë influencerët ndaj konsumatorëve kur reklamojnë produkte, për ankesat eventuale në rastet kur nuk bëhet e qartë se një përmbajtje është reklamë, dhe masat e ndërmarra në rast të tilla, REL-i kërkoj sqarime nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë,

Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI), por nuk mori përgjigje.

Nga reklamat klasike tek influencerët

Për bizneset, megjithatë, influencerët janë bërë pjesë e rëndësishme e marketingut. Shërbime të marketingut përmes influencerëve ofron agjencia "Rrjeta Advertising", ka bërë me dije drejtori i saj, Donat Mustafa.

Mustafa ka thënë se ka raste kur klientët e kërkojnë këtë shërbim, por edhe vetë agjencia e propozon atë, kur vlerëson se marketingu përmes influencerëve mund të ndihmojë në arritjen e objektivave të një fushate. "Marketingu me influencerë është pjesë e shërbimeve tona prej disa vitesh. Rritja e përdorimit të rrjeteve sociale dhe besimi që audiencia krijon ndaj krijuesve të përmbajtjes kanë bërë që ky kanal të jetë gjithnjë e më i rëndësishëm. Gjatë kësaj kohe kemi realizuar bashkëpunime të suksesshme në sektorë të ndryshëm", ka thënë Mustafa.

"REL"-i ka pyetur edhe se sa paguhen influencerët për angazhime të tilla, por nga kjo agjenci nuk kanë dhënë informacione. Një agjenci tjetër, në kushte anonimiteti, ka thënë se influencerët mund të paguhen nga 200 deri në 5 000 euro, "varësisht nga ndikimi dhe fama që kanë".

Si i zgjedhin kompanitë influencerët?

"REL"-i ka kontaktuar dhjetë biznese që kanë angazhuar influencerë për reklamimin e produkteve apo shërbimeve të tyre. Deri në publikimin e këtij artikulli, përgjigje ktheu vetëm rrjeti i dyqaneve Jumbo. Genta Varangu nga departamenti i marketingut në "Jumbo", ka thënë se bashkëpunimi me influencerë u ka ndihmuar të komunikojnë me audiencën në

mënyrë më autentike dhe kreative. Sipas saj, angazhimi i influencerëve ka qenë "një hap natyral" në zhvillimin e strategjisë së marketingut të kompanisë. "Ka qenë përgjigje ndaj ndryshimit të mënyrës se si konsumatorët informohen, ndërveprojnë me markat dhe marrin vendime për blerje", ka thënë Varangu.

Ajo ka treguar se komunikimi me influencerët bëhet në dy mënyra: drejtpërdrejt me ta ose përmes agjencive që i përfaqësojnë. Përzgjedhja, sipas saj, varet nga objektivat e fushatës dhe audiencia që synon biznesi. "Marrim në konsideratë audiencën e influencerit, përputhshmërinë me vlerat e markës, cilësinë e përmbajtjes që krijon dhe angazhimin që gjeneron me ndjekësit e tij apo saj", ka thënë Varangu. Ajo ka thënë se kushtet e bashkëpunimit, përfshirë edhe kompensimin, dallojnë në varësi nga objektivat, formati dhe kohëzgjatja e fushatës.

Rregullat ekzistuese dhe praktikat evropiane

Edhe pse legjislacioni i Kosovës nuk ka rregulla të posaçme për influencerët, Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit kërkon që promovimi me karakter komercial të jetë i qartë për konsumatorin, dhe të mos qarqitet si përmbajtje e zakonshme apo e pavarur. Në Bashkimin Evropian, marketingu përmes influencerëve trajtohet kryesisht përmes rregullave për mbrojtjen e konsumatorit dhe transparencën e përmbajtjes komerciale. Parimi kryesor është që publiku duhet ta dijë kur një postim është reklamë, sponsorizim apo bashkëpunim i paguar. Ky rregull aplikohet edhe në shtetet anëtare të BE-së, ndonëse secili vend ka specifikat e veta. Për shembull, Franca në vitin 2023 ka miratuar ligj të veçantë për influencerët. Sipas BE-së, ata janë të obliguar që të specifikojnë kur një përmbajtje realizohet nga partneriteti me ndonjë markë, apo edhe kur paguhen për të promovuar produktet. Edhe nëse këtë e përmendin në videot që publikojnë, ata duhet të shoqërojnë postimin me etiketat si #sponsorizuar, #reklamë, e të tjera. Ndonëse jo me ligj të veçantë, edhe në Itali, Gjermani e Portugali nuk lejohen reklamimet e fshehta, derisa kërkohet që influencerët të përdorin hashtag-ët në përmbajtjet e tyre. Në Finlandë, përveç reklamave, influencerët duhet t'i informojnë konsumatorët edhe kur produktet që promovojnë u janë dhuruar.

PSE TRUMP PO E SULMON SËRISH IRANIN DHE DERI KU DËSHIRON (OSE MUND) TË SHKOJË

Një tjetër paradoks tipik i Donald Trumpit



Giuseppe Sarcina –
Corriere della Sera

Të mërkurën, më 8 korrik, presidenti amerikan i dha një kthesë të papritur samitit të NATO-s në Ankara, duke kritikuar aleatët, përfshirë edhe Italinë, se nuk e kishin mbështetur në përballjen me Iranin. Në të njëjtën kohë, ai urdhëroi bombarduesit amerikanë të godisnin 80 objektiva në territorin iranian.

Edhe një herë, Trump nuk e pa të nevojshme t'i paralajmëronte, aq më pak t'i konsultonte, liderët me të cilët kishte darkuar një natë më parë. As presidentin francez Emmanuel Macron, as kryeministrin britanik Keir Starmer, as kancelarin gjerman Friedrich Merz dhe as kryeministrin italiane

Giorgia Meloni.

Ndoshta, por kjo nuk është e konfirmuar, presidenti amerikan mund ta ketë diskutuar çështjen me presidentin turk Recep Tayyip Erdoğan gjatë takimit dypalësh të zhvilluar të martën, më 7 korrik.

Në çdo rast, rifillimi i luftimeve ka rikthyer alarmin si në Evropë, ashtu edhe te partnerët arabë të Gjirit. Sipas diplomatëve evropianë, shpjegimi më i besueshëm është se Memorandumi i Mirëkuptimit, i nënshkruar më 17 qershor nga Trump dhe presidenti iranian Masoud Pezeshkian, nuk i rezistoi provës së realitetit në një çështje kyçe: kontrollin e Ngushticës së Hormuzit.

Ditët e fundit, Gardat Revolucionare iraniane sulmuan tre anije cisternë naftë, njëra prej të cilave

mbante flamurin e Katarit, pasi po ndiqnin një itinerar që nuk ishte miratuar nga Irani. Sipas vlerësimeve, ato besonin se gëzonin mbështetjen amerikane. Megjithatë, javët e fundit interpretimet e ndryshme të memorandumit janë shndërruar në një përplasje gjithnjë e më të fortë në këtë korridor detar, përmes të cilit kalon rreth 20% e naftës që konsumohet në botë.

Për Uashingtonin, lundrimi duhet të rikthehet i lirë, ashtu siç ishte para luftës. Për Teheranin, situata ka ndryshuar: kushdo që dëshiron të kalojë duhet të paguajë një tarifë tranziti. Tani vëmendja është përqendruar te zhvillimet e ardhshme. Deri ku mund të shkojë Trump? Si do të reagojë Irani? Shqetësimi është i madh, jo vetëm në Evropë, por


edhe brenda administratës amerikane dhe mes ligjvënësve republikanë.

Çmimi i naftës po rritet me shpejtësi në tregjet ndërkombëtare, me një rritje prej rreth 6% dhe me pritshmëri për rritje të mëtejshme. Për Evropën kjo mund të nënkuptojë rikthimin e pasigurisë ekonomike. Edhe për Shtetet e Bashkuara perspektivat janë të vështira, veçanërisht për shtresën e mesme dhe atë me të ardhura më të ulëta, si edhe për bizneset, ndërsa çmimi mesatar i benzinës mbetet rreth 4 dollarë për gallon (3.7 litra).

Në këtë situatë, si do të veprojë Trump? Edhe këtë herë përgjigjja mbetet e paqartë. Megjithëse ka vijuar me deklarata të ashpra ndaj udhëheqjes iraniane, presidenti amerikan nuk e ka

anuluar procesin e negociatave të parashikuar në marrëveshjen paraprake, e cila parashikonte një periudhë prej 60 ditësh duke filluar nga mesi i qershorit. Kjo lë të kuptohet se faza e re e tensioneve mund të mbetet e kufizuar dhe të mos përshkallëzohet në një luftë të përgjithshme.

Ndërkohë, një tjetër polemikë ka përfshirë Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Mark Rutte. Ai u nxitua të lavdëronte bombardimet amerikane, pa qenë e qartë në çfarë cilësie dhe në emër të kujt e bëri këtë. Sigurisht, jo në emër të qeverive kryesore evropiane, të cilat, sipas raportimeve, janë irrituar nga qëndrimi i tij i perceptuar si tepër pro-Trump. Për shumë vëzhgues, kjo është bërë tashmë një skenë e zakonshme në politikën ndërkombëtare.



Zvicra në çerekfinale të Kupës së Botës, Xhaka dhe Messi përballë njëri-tjetrit

VANCOUVER, 8 KORRIK - Zvicra e Granit Xhakës është kualifikuar në çerekfinale të Kupës së Botës në futboll. Helvetikët e kanë mposhtur Kolumbinët pas penalltive me

rezultat 4:3. Skuadra e Murat Yakin ka dështuar një herë nga pika e bardhë pasi Manuel Akanji nuk është treguar i saktë. Derisa te kolumbianët nga pika e

bardhë kanë dështuar Campas dhe Hernandez. Në fazën tjetër Zvicra do të ketë punë me Argjentinën e cila ka bërë "Remuntada" ndaj Egjiptit, duke e rikthyer

rezultatit nga 0:2 në 3:2. Përballja Argjentina - Zvicra do të luhet të dielën më 12 korrik me fillim nga ora 03:00 e mëngjesit, sipas kohës sonë lokale.



DRENICA MËSON KUNDËRSHTARËT NË LIGËN E KAMPIONËVE NË FUTSALL

NYON, 8 KORRIK - Është hedhur shorti për raundin paraeliminativ të Ligës së Kampionëve në futsal, ndërsa kampionia e Kosovës, Drenica, do të garojë në Grupin D. UEFA ka hedhur në Nyon të Zvicrës shortin për raundin paraeliminativ të Ligës së Kampionëve në futsal për edicionin e ri, ku kampionia e Kosovës, Drenica, ka mësuar kundërshtarët me të cilët do të përballë në garën evropiane. Skuadra nga Kosova do të ketë përballë Ujpest FC nga

Hungaria, S. S. Murata nga San Marino dhe Sakarya Karasu 1933 SK nga Turqia. Drenica do të synojë ta kalojë me sukses këtë fazë dhe të sigurojë një vend në "Main Roun" të Ligës së Kampionëve, përballë kundërshtarëve që premtojnë sfida të forta. Ndeshjet e raundit paraeliminativ do të zhvillohen në format turneu, në një vend organizues të vetëm, gjatë periudhës 25-30 gusht 2025, ku secila skuadër do të luajë nga tri ndeshje. Nga kjo fazë fituesit e



tetë grupeve do të sigurojnë kualifikimin në raundin kryesor të Ligës së Kampionëve, ku do t'u bashkohen skuadrave me koeficient më të lartë të UEFA-s. Në varësi të numrit përfundimtar të pjesëmarrësve, mund të kualifikohen edhe disa nga vendet e dyta me bilancin më të mirë. Tashmë kampionët e Kosovës do t'i nisin përgatitjet për ndeshjet e raundit paraeliminativ, me synimin për të përfaqësuar sa më denjësisht futbollin e Kosovës në arenën evropiane.

YLBER RAMADANI TRANSFEROHET TE KLUBI I SUPERLIGËS SË TURQISË



ÇORUM, 8 KORRIK - Mesfushori i Kombëtares së Shqipërisë, Ylber Ramadani, është larguar nga Lecce dhe ka nisur një aventurë të re në futbollin turk, pasi ka nënshkruar kontratë me klubin ARCA Çorum FK. Klubi turk e ka konfirmuar marrëveshjen përmes një njoftimi në kanalet zyrtare,

duke bërë me dije se ka arritur pajtim me US Lecce për transferimin përfundimtar të mesfushorit shqiptar. "Klubi ynë ka arritur një marrëveshje me US Lecce në lidhje me transferimin përfundimtar të futbollistit profesionist Ylber Ramadani dhe është nënshkruar një kontratë 2+1-

vjeçare me lojtarin. Me besimin se ai do të ketë një karrierë të suksesshme nën fanellën e ARCA Çorum FK, e mirëpresim Ylber Ramadanin dhe i urojmë suksese të shkëlqyera në udhëtimin e tij të ri", ARCA Çorum FK. Për Ramadanin, ky është një kapitull i ri në karrierën e tij,

pasi pas përvojës në futbollin italian me Leccen, tashmë do të kërkojë të japë kontributin e tij në elitën e futbollit turk, ku pritet të jetë një nga shtyllat e mesfushës së skuadrës së re. Transferimi i mesfushorit ferizajas është thënë se i ka kushtuar një milion euro klubit turk.

PRISHTINA KONFIRMON ZYRTARISHT NËNSHKRIMIN ME ALBIN KRASNIQIN

PRISHTINË, 8 KORRIK - Klubi kryeqytetas, Prishtina, ka njoftuar zyrtarisht se ka nënshkruar kontratë të përhershme me mesfushorin me tipare sulmuese, Albin Krasniqi. Pas një huazimi gjashtëmujor nga klubi ukrainas Kolos, Prishtina ka vendosur ta blejë kartonin e

futbollistit nga Kaçaniku dhe ta bëjë pjesë të përhershme të skuadrës bardhekaltër. Lajmi është bërë me dije nga klubi më i trofeshëm i Kosovës, i cili ka konfirmuar marrëveshjen me Krasniqin. Mesfushori ofensiv nuk është një emër i panjohur për Prishtinën, pasi ai edhe më herët ka qenë pjesë



e këtij klubi, duke kontribuar në arritjen e rezultateve të mira dhe duke fituar edhe trofe me fanellën bardhekaltër. "Rrugëtimi i Albin Krasniqit me fanellën bardhekaltër vazhdon. Mesfushori ofensiv ka nënshkruar kontratë me Prishtinën, pasi në pjesën e

dytë të sezonit të kaluar ishte pjesë e skuadrës si i huazuar nga klubi ukrainas Kolos", ka njoftuar Prishtina. Me këtë marrëveshje, Prishtina vazhdon punën për konsolidimin e skuadrës dhe përforcimin e repartit ofensiv para sfidave të reja në sezonin e ardhshëm.

Zyrtare: Zlatko Daliq largohet nga Kroacia pas Botërorit 2026

ZAGREB, 8 KORRIK - Zlatko Daliq ka vendosur t'i japë fund aventurës së tij në krye të Kombëtares së Kroacisë pas përfundimit të Kupës së Botës 2026. Vendimin ai ia ka bërë të ditur Federatës Kroate të Futbollit gjatë një takimi me presidentin Marijan Kustiq. Daliq mori drejtimin e

Kroacisë në vitin 2017 dhe u bë trajneri më i suksesshëm në historinë e kombëtares. Nën drejtimin e tij, Kroacia arriti në finalen e Kupës së Botës 2018, ku fitoi medaljen e argjendtë, më pas medaljen e bronzit në Botërorin 2022 dhe medaljen e argjendtë në Ligën e Kombeve në vitin 2023. Ai gjithashtu e

kualifikoi ekipin në Kampionatet Evropiane 2020 dhe 2024, si dhe në Kupën e Botës 2026. Në deklaratën e tij, Daliq tha se drejtimi i kombëtares ishte nderi më i madh i karrierës së tij dhe se ndihet krenar për sukseset e arritura, por edhe për lidhjen e krijuar mes ekipit dhe tifozëve

kroatë. "Ka ardhur koha. Edhe pse ende kam ambicie për suksese të reja, besoj se ky është momenti i duhur për t'i dhënë fund kësaj epoke të jashtëzakonshme", u shpreh ai. Daliq largohet pas gati nëntë vitesh në krye të Kroacisë, duke lënë pas një periudhë historike që e



shndërroi kombëtares në një nga ekipet më të respektuara të futbollit ndërkombëtar.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

